



**K.DH.SH.II.nr.977/22**

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS** - Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Faton Bajrami, kryetar i kolegjit, Saranda Bogaj Sheremeti dhe Ramush Bardiqi, anëtar të kolegjit, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit NTP A... nga Prishtina, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Sh.A “SCLR Partners” Sh.P.K me seli në Prishtinë Soliteri Avalla P+12, kundër të paditurës Dogana e Kosovës (DK) në Prishtinë, me bazë juridike, anulim vendimi, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës, ushtruar kundër Aktgjyqimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal, A.nr.855/18, të datës 21.09.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 23.02.2023, merr këtë:

### **A K T G J Y K I M**

**Refuzohet** si e pa bazuar ankesa, e të paditurës Dogana e Kosovës në Prishtinë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative - Divizioni Fiskal, A.nr.855/18, të datës 21.09.2021, **vërtetohet**.

### **A r s y e t i m i**

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative - Divizioni Fiskal, A.nr.855/18, të datës 21.09.2021, është aprovuar si e bazuar kërkesëpadia e paditësit NTP A... nga Prishtina, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Sh.A “SCLR Partners” Sh.P.K me seli në Prishtinë Soliteri Avalla P+12, si e bazuar, Anulohet aktvendimi nr.07.3/1763/2014 i datës 09.03.2018, i Doganës së Kosovës në Prishtinë. Obligohet e paditura Doganës së Kosovës në Prishtinë, që paditësit NTP A... nga Prishtina, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Sh.A “SCLR Partners” Sh.P.K me seli në Prishtinë Soliteri Avalla P+12, t’ia kthej shumën prej 12,055.99€ (dymbëdhjetë mijë, e pesëdhjetë e pesë euro, e nëntëdhjetë e nëntë cent) të cilat detyrime janë paguar sipas Deklaratave Unike Doganore R-40350/03.11.2014 dhe R-41708/12.11.2014 të ZBD Prishtinë, si dhe t’ia paguaj kamatën vjetore ligjore prej 8% nga data kur është bërë pagesa e detyrimeve doganore e deri në përmbushjen definitive të detyrimit.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë e paditura, për shkak të: zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, vërtetimit të gabuar të së drejtës materiale dhe shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës së LKA-së. Me propozim që të aprovohet në tersi si e bazuar ankesa e të paditurës – Dogana e Kosovës, Prishtet aktgjykimi A.nr.855/18 të datës 21.09.2021 si i pa bazuar me ligj, ta refuzon padinë dhe kërkesën e paditësit në tërësi si të pa bazuar me ligj dhe ta lë në fuqi vendimin e kontestuar ose ta kthej lëndën në rivendosje.

Përgjigje në ankesë ka parashtruar i autorizuari i paditësi me të cilin ka propozuar që të refuzohet në tërësi ankesa e palës së paditur si e pa bazuar si dhe të vërtetohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti Administrativ – Divizioni Fiskal A.nr. 855/18 të datës 21.09.2021 si i bazuar.

Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë, shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore në ankesë, dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 49 të LKA-së, nenit 81.H të Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat nr.03/L-222, lidhur me nenin 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA), gjeti se:

**- Ankesa është e pa bazuar**

Nga shkresat e lëndës rezulton se me Aktvendimin e kundërshtuar nr.07.3/1763/2014 i datës 09.03.2018, është refuzuar si e pabazuar kërkesa e subjektit në procedurë NTP “A...” nga Prishtina, për rishqyrtimin vendimeve nr. R-40350/03.11.2014 dhe R-41708/12.11.2014 të Zyrës së Brendshme Doganore Prishtinë si e pabazuar.

Paditësi i pakënaqur me vendimin e të paditurës, ka ushtruar padi për konflikt administrativ, me pretendim se i njëjti është i padrejtë dhe i paligjshëm. Gjykata e shkallës së parë, pas shqyrtimit të padisë së paditësit, si dhe pas administrimit të provave si në procesverbal të shqyrtimit kryesor, e duke u bazuar edhe në provat dhe dëshmitë e tjera të lëndës, bie aktgjykimin e ankimuar me të cilin kërkesëpadinë e paditësit NTP A... nga Prishtina, ka aprovuar, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Sh.A “SCLR Partners” Sh.P.K me seli në Prishtinë Soliteri Avalla P+12, si e bazuar, Anulohet aktvendimi nr.07.3/1763/2014 i datës 09.03.2018, i Doganës së Kosovës në Prishtinë. Obligohet e paditura Doganës së Kosovës në Prishtinë, që paditësit NTP Ardi Tours nga Prishtina, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Sh.A “SCLR Partners” Sh.P.K me seli në Prishtinë Soliteri Avalla P+12, t’ia kthej shumën prej 12,055.99€ (dymbëdhjetë mijë, e pesëdhjetë e pesë euro, e nëntëdhjetë e nëntë cent) të cilat detyrime janë paguar sipas Deklaratave Unike Doganore R-40350/03.11.2014 dhe R-41708/12.11.2014 të ZBD Prishtinë, si dhe t’ia paguaj kamatën vjetore ligjore prej 8% nga data kur është bërë pagesa e detyrimeve doganore e deri në përmbushjen definitive të detyrimit. Me arsyetim se nga administrimi i provave në këtë konflikt administrativ, gjykata konstaton se paditësi ka dëshmuar para të paditurës dhe gjykatës, DUD-at R-40350/03.11.2014 dhe R-41708/12.11.2014 të ZBD Prishtinë, faturat përcjellëse të mallit, pagesat bankare, kontratën e shitblerjes. Gjykata provat e lëndës i ka vërtetuar edhe përmes ekspertizës financiare të datës 26.02.2021 dhe Plotësimit të ekspertizës financiare datë 14.06.2021 dorëzuar gjykatës dhe palëve ndërgjyqëse në seancën gjyqësore, nga ku ka rezultuar se me rastin e paraqitjes së mallit doganor për zhdoganim paditësi ka bashkangjitur të gjitha dokumentet përcjellëse konform nenit 33 të Kodit Doganor dhe të Akcizave dhe nenit 123 të UA 11/2009. Lidhur me diferencën e detyrimeve të paguara më tepër në emër të detyrimeve doganore shumën prej 12,055.00€ të cilën e ka precizuar ekspertja financiare në Plotësimin e ekspertizës financiare datës 14.06.2021 si dhe gjatë seancës gjyqësore datë 14.09.2021, palët ndërgjyqëse nuk e kanë kontestuar para gjykatës, ndërsa sa i përket dokumentacionit të prezantuar nga paditësi, gjykata ia

ka falur besimin ekspertes gjyqësore financiare e cila në plotësim të ekspertizës dhe në seancë gjyqësore ka precizuar deklarimet se në bazë të dy deklarimeve doganore faturat dhe transferi bankar është i harmonizuar, ku edhe gjatë seancës të shqyrtimit kryesor e autorizuar e paditësit i ka dorëzuar gjykatës pagesën bankare të vulosur nga Banka “...” të datës 19.05.2021. Gjykata ka konstatuar se edhe përkundër që kjo çështje ishte kthyer në rivendosje tek e paditura, sipas aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë A.nr. 432/15 të datës 07.02.2018 në rivendosje e paditura ka nxjerr aktvendimin e kontestuar në kundërshtim me pikëpamjet juridike të gjykatës dhe vërejtjet e dhëna dhe në këtë mënyrë e paditura ka vepruar në kundërshtim me nenin 65 të LKA-së, ku parashihet karakteri i detyrueshëm i aktgjykimit. Nga një gjendje e tillë faktike rezulton se e paditura ka nxjerr vendim të ri në rivendosje duke mos bërë vlerësimin e dokumentacionit përcjellës të mallit dhe mos sqarimit se cila bazë ligjore kërkon që deklaratës doganore duhet bashkangjitur deklarata eksportuese. Edhe pse gjykata ka kërkuar nga e paditura të deklarohet lidhur me provat e paraqitura nga paditësi si fatura e mallit lëndor, transaksioni bankar, kontrata e shitblerjes dhe dokumentet tjera përcjellëse, mirëpo në rastin konkret e paditura i është shmangur këtij rekomandimi të gjykatës për mos anashkalimin e metodave të vlerësimit pa u vërtetuar gjendja faktike e dokumentacionit të mallit lëndor se është paguar vlera e transaksionit sipas faturës së mallit konform nenit 33 të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës 03/L-109.

Qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërësi e pranon edhe kjo gjykatë, për arsye se aktgjykimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative, të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative. Gjykata e shkallës së parë duke vlerësuar ligjshmërinë e aktvendimit të kontestuar në kuptim të nenit 38 të Ligjit për Konfliktet Administrative, në drejtim të thënieve në padi, në përgjigje në padi, provave të administruara në seancë gjyqësore, si dhe pas shqyrtimit të shkresave të tjera të lëndës me të drejtë ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit duke vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar. Sa i përket pretendimeve ankimore të paditurës, se gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës, këto pretendime ankimore nuk qëndrojnë, ngase aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë nuk është i përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës administrative, e as me shkelje të tjera të cilat do të ndikonin në drejtshmërinë dhe ligjshmërinë e aktgjykimit të goditur. Meqë gjykata ka shqyrtuar padinë, fillimisht e ka dërguar padinë përfaqësuesit të paditurës në përgjigje në padi, pastaj ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor, ka nxjerr prova të mjaftueshme, që do të thotë se gjatë vlerësimit gjykata e shkallës së parë nuk ka bërë shkelje të dispozitave të LKA-së, dhe LPA-së. Ndërsa, sa i përket pretendimeve ankimore të paditurës, për vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, këtë pretendim Dhoma e Shkallës së Dytë, e refuzon si të pa bazuar. Në rastin konkret kjo gjykatë, as në ankesë, e as në shkresat e lëndës, nuk ka gjetur asnjë provë bindëse që dëshmon konstatimin se paditësi ka deklaruar vlerë më të vogël se sa vlera reale e paguar për eksport në vendin tonë, ashtu siç e përcakton neni 33 i Kodit Doganor dhe i Akcizave të Kosovës. Në këtë rast e paditura para gjykatës është dashur që me prova bindëse të dëshmojë se ia ka paguar paditësit – eksportuesit të mallit vlerën më të vogël se sa vlera e deklaruar me DUD-in kontestues, si dhe faturën përcjellëse të mallit lëndorë, gjë që nuk e ka bërë një gjë të tillë. Të paditurës i është dhënë mundësia nga ana e gjykatës së shkallës për që përmes rekomandimeve të gjykatës të bëjë verifikimi i vërtetësisë së

dokumentacionit përcjellës të mallit lëndor, por edhe përkundër kësaj, e paditura refuzon kërkesën e paditësit dhe konfirmon rivlerësimin e Zyrës së Pranimit Qendror e cila e ka rivlerësuar mallin lëndor me metodën e 6 të vlerësimit nëni 35 të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës respektivisht në bazë të dhënave të disponueshme-dosja e vlerës, duke mos bërë vlerësimin e dokumentacionit përcjellës të mallit dhe mos sqarimit se cila bazë ligjore kërkon që deklaratës doganore duhet bashkangjitur deklarata eksportuese. Gjithashtu gjykata ka kërkuar nga e paditura të deklarohej lidhur me provat e paraqitura nga paditësi si fatura e mallit lëndor, transaksioni bankar, kontrata e shitblerjes dhe dokumentet tjera përcjellëse, mirëpo në rastin konkret e paditura i është shmangur këtij rekomandimi të gjykatës për mos anashkalimin e metodave të vlerësimit pa u vërtetuar gjendja faktike e dokumentacionit të mallit lëndor se është paguar vlera e transaksionit sipas faturës së mallit, konform nenit 33 të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës 03/L-109. Dhoma e Shkallës së Dytë, e vlerëson si të drejtë dhe të ligjshëm vlerësimin e gjykatës së shkallës së parë me të cilën ka vlerësuar se paditësi ka dëshmuar para të paditurës dhe gjykatës për DUD R-40350 faturën me nr.1929 të datës 30.09.2014 në shumë prej 48,888.00USD dhe DUD R-41708 faturën me nr.1930 datë 06.10.2014 në shumë prej 47,425.00USD si dhe vëzhgimi i urdhër transferit ndërkombëtar të datës 19.05.2021 me shumën prej 96,313.00USD i cili harmonizohet me DUD-at dhe faturat përcjellëse të mallit, kontratën e shitjes dhe dokumentet tjera përcjellëse të cilat dokumentacione janë në tersi të harmonizuara në kuptim të vlerës së mallit në përputhje me dispozitat e nenit 123 të Udhëzimit Administrativ 11/2009 për Implementimin e Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës, andaj gjykata konstaton se janë përmbushur kriteret ligjore për tu pranuar vlera e deklaruar sipas faturës së mallit të deklaruar me Deklaratën Unike Doganore nr. R-40350/03.11.2014 dhe R-41708/12.11.2014 të Zyrës Doganore Prishtinë. Prandaj, një veprim i tillë është në përputhje me dispozitat ligjore nga ligji nr.03/L-109. E paditura nuk ka bërë një vlerësim të drejtë me rastin e përcaktimit të vlerës së mallit doganor dhe në asnjë moment nuk ka nxjerr konkluzion të drejtë në aspektin e gjendjes faktike, në raport me dokumentacionin e mallit të paraqitur me DUD-at nr. R-40350/03.11.2014 dhe R-41708/12.11.2014 të Zyrës Doganore Prishtinë.

Nga tërë kjo që u cekë më lartë dhe mbi këtë gjendje faktike, kjo gjykatë konsideron se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, ngase nuk është cenuar ligji në dëm të paditurës. Prandaj, pretendimet ankimore në ankesë se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar edhe të drejtën materiale në dëm të paditurës, ky kolegji nuk i aprovoi, sepse vlerësoi se të njëjtat janë të paqëndrueshme dhe të pa bazuara për tu aprovuar ankesa, dhe se janë të pa ndikim në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike nga ajo e vërtetuar edhe nga gjykata e shkallës së parë. Sepse, aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë, është i qartë dhe i kuptueshëm si dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare, të cilat i pranon edhe kjo gjykatë, andaj, ankesa e të paditurës u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm. Duke marrë parasysh se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale, me rastin e aprovimit të kërkesëpadisë së paditëses, e pasi që me pretendimet tjera ankimore të përsëritura, të njëpasnjëshme, një aktgjykim i tillë nuk mund të vihet në pyetje, ankesa e të paditurës, u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 49 të LKA-së, lidhur me nenin 200 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**  
**Dhomat e Shkallës së Dytë**  
**K.DH.SH.II.nr.977/22, me datë 23.02.2023**

**Kryetar i kolegjit,**  
**Faton Bajrami**